



REPUBLIKA KOSOVË
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr. _____
No. 09.052/01.000/659/26
Data. _____
Data. 12.01.2026



KOMUNA SKENDERAJ
OPŠTINA SKENDRAJ
MUNICIPALITY OF SKENDERAJ

Drejtoria për Shërbime Publike
Direkcija za Javne Službe
Department for Public Services

DATË/A:	12.01.2026
PËR/ZA/TO:	Zyrën e Kryetarit të Komunës së Skenderaj, z. Sami Lushtaku
PERMES	Arkivit
NGA/OD/FROM:	D.Sh.P, Drejtori – (i Autorizuar) z. Hajzer Shala
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Raporti Vjetor për Drejtorin për Shërbime Publike 2025



Nga data 01.01.2025 Sektori për Shërbime Publike fillon punën me Organizimin e detyrave të përcaktuara sipas rregullores së punës për Shërbime Publike, punë të cilat janë të shpërndara nëpër zyrtarë sipas vendeve të punës të cilët janë të emëruar në bazë të Aktemrimeve.

Aktivitetet ditore për muajin Janar kemi filluar me pranimin e kërkesave nga palët, shqyrtimin e tyre, si dhe shikimin e gjendjes në teren, sipas kërkesave të parashtruara.

Kemi angazhuar kompaninë kontraktuese për mirëmbajtjen e ndriçimit publike, në eliminimin e defekteve në Runik, Bajë dhe lokacioneve të tjera. E gjithë puna është përcjellë nga zyrtarët e Sektorit për Shërbime Publike. Gjatë muajt Janar në disa lokacione, kishim bllokime të kanalizimeve, ku kemi angazhuar Operatorin Kontraktues për deblokim të Kanalizimit, si në Kopiliq të Poshtëm, në Rr.18 Qershori në Skenderaj, në rr. Hashim dhe Bislim Lushtaku, dhe në rr. 28 17 Shkurti.

Nga muaj Shkurt, kemi angazhuar Kompaninë Kontraktuese “Deshishku” në de bllokime dhe në rregullime të kanalizimeve në shumë lokacione. Si në Prekaz të Poshtëm, Ternavc , Llaushë, në Rr. Shaban Mangjoll në Skenderaj, Rr. Murat Loshi në Padalishtë, Rr. Adem Demaqi në Skenderaj, në Llaushë dhe në Rr. Azem Bejta në Skenderaj.

Kemi angazhuar Kom BITI” për mbjelljen e drunjtëve dekorativ në Rr. 17 Shkurti.

Kemi angazhuar zyrtarët ,për daljen në teren në Prekaz të Epërm , pasi që kishim informacione , se nga njerëz te pa ndërgjegjshëm , ishte dëmtuar stacioni i autobusëve , i sapo i ndërtuar.

Të gjithë zyrtarët e Sektorit për Shërbime Publike kemi qenë të angazhuar, në incizimin e terrenit për shtrirjen e ndriçimit publik në fshatrat e Komunës së Skenderajt.

Janë mbledhur të gjitha të dhënat për Raportin e Performancës Komunale, të cilat ishin në kompetencë të Drejtorisë për Shërbime Publike nga zyrtarët përgjegjës.

Edhe gjatë muajt Mars , kemi pas kërkesa rrethe mirëmbajtjes së rrjetit të kanalizimit, ku kemi intervenuar në disa lokacione , si në Prekaz të Epërm , Lagjen III dhe në rr. Naim dhe Fidaim Musliu në Skenderaj. Puna është kryer nga Operatori Kontraktues “Deshishku”.

Edhe gjatë muajt Mars , kemi pas kërkesa rrethe mirëmbajtjes se rrjetit të kanalizimit, ku kemi intervenuar ne disa lokacione , si ne Prekaz te Epërm , Lagjen III dhe ne rr. Naim dhe Fidaim Musliu ne Skenderaj. Puna është kryer nga Operatori Kontraktues “Deshishku”.

Me që kërkesat edhe ne muajin prill, ishin të natyrave të ndryshme , që bien ne kompetencë të Sektorit për Shërbime Publike, unë si udhëheqës i sektorit , së bashku me zyrtaret , kemi qenë të angazhuar ne shqyrtimin e kërkesave, ne përcjelljen e punimeve, ku janë kryer disa intervenime ne rrjetin e kanalizimit nga Kompania Deshishku, ne Burojë Lagjja Jusolli, Ne Rr. Ahmet Delia, afër Shashit” Adem Jashari” ku gjatë gjithë kohës është monitoruar edhe nga Menaxheri i Kontratës, në Rr.17Shkurt, Ne Likoc te Ri, si dhe ne Rezallë ne lagjen Malaj. Janë mbajtur trajnime me DEMOS-in për kushtet klimatike, pjesëmarrës kemi dërguar Zyrtarin për Menaxhimin e Mbeturinave.

Në këtë muaj kishim defekte të shumta edhe ne rrjetin e ndriçimit publik , ku me kompaninë kontraktuese , kemi arrit te evitojmë te gjitha defektet ne të gjitha rrugët e Qytetit të Skenderajt.

Kompania Regjionale KRUM, njësia ne Skenderaj, ka kryer disa intervenime, si pas kërkesës tonë si Drejtori, ne disa lokacione, brenda qytetit, në rrjetin e ujësjellësit, si dhe te kanalizimit.

Gjatë muajt Maj, kemi angazhuar Kompaninë Deshishku” ne disa lokacione për intervenim ne rrjetin e kanalizimit , si ne Rr. 28.Nëntori ne Skenderaj ne Kopiliq të Poshtëm, në Rr. Naser Gashi” Ne Turiqec , ne Laxhen Kabashi ne Polac, Laxha Haziraj ne Llaushë, ne Rr. Qazim Ibishi ne Klinë te Poshtme , ne Rr. Ali Gashi dhe ne Rr. Fadil Rustemi.

Është bërë pastrimi,(eliminimi) i deponive ilegale ne disa lokacione , nga operatori kontraktues, e gjithë puna është përcjellë nga Zyrtari për menaxhimin e mbeturinave.

Muajin Qershor , deblokime te kanalizimit, si ne Rr. Miftar Rreci ne Llaushë, pikërisht ne Prekaz Laxha Lushtaku, në Rr. Imer Velu ne Skenderaj, në Rr. Emin Lati në Skenderaj, ne Rugën Myftar Bajraktari, të shtëpia e Pleqve, dhe lokacione te tjera, ne ndërrimin e kapakëve të pusetave, punë e cila është punuar nga operatori kontraktues Deshishku’.

Është punuar , ne eliminimin e Deponive Ilegale , ne disa lokacione si dhe është bërë vendosja e shenjave vedisuese, parandaluese për hedhjen e mbeturinave nga Zyrtari për Menaxhimin e Mbeturinave.

Kemi vazhduar me punimet ne rrjetin e ndriçimit publik, ne shtrirjen e rrjetit dhe eliminimin e defekteve ne rrjet, si dhe ne mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit ne fshatra dhe ne Qytet me operoret kontraktues.

Edhe muaj Korrik ka qenë shumë i ngarkuar me kërkesa të Qytetareve të natyrave të ndryshme, si kërkesa për deblokim te kanalizimit, kërkesa për ndriçim publik, dhe kërkesa të tjera, ku në të gjitha këto kërkesa , si sektor, kemi dalë ne teren, kemi kontaktua gjendjen dhe kemi angazhuar Kompanitë kontraktuese, ne zgjedhjen e këtyre problemeve.

Kemi angazhua Kompaninë Kontraktuese, ne deblokim ,te kanalizimeve, rregullimin e pusetave, shtrirjen e gypave, ku kanë qenë të shtypur (të dëmtuar) dhe ju kemi ofrua zgjedhje, si ne Prekaz, Laxha Lushtaku, ndërrim te gypit ne një lartësi prej 25 m, me laxhen kabashi ne Polac, deblokime , në Runik, rregullimin e pusetave të dëmtuara në Rr. Bashkim Kerolli, shtrirje, e rrjetit te kanalizimit, në një lartësi prej 180m.

Po ashtu edhe në muajin Gusht, kemi bërë shqyrtimin e disa kërkesave rrethe çështjes se rrjetit te kanalizimit ku nga Kompania Deshishku janë kryer de bllokime të kanalizimit ,ne laxhen Kodra ne Prekaz të Poshtëm , Lagja Ahmeti dhe Zabeli ne Rezallë, ne Rr.17 Shkurti afër Parkingut publik, Prekaz te Poshtëm Lagja Lushtaku, ne Makermal Lagjja Xhinovci, ku kemi vazhduar punimet edhe gjatë ditëve te Vikendit.

Kompania për shtrirjen e Ndriçimit Publik, ka qenë e angazhuar në shtrirjen e rrjetit ne fshatrat e Komunë së Skenderajt.

Edhe gjatë muajit Shtator , kemi qenë shumë të ngarkuar me kërkesa të qytetareve te Komunës se Skenderajt , rrethe rrjetit te ndriçimit publik dhe kanalizimit , ku kemi angazhuar operatoret kontraktues për intervenim , si ne fshatin Mikushnicë Lagjja Avdiu, ku janë bërë shtrirje të, gypave ,pasi që kanë qenë të shtypur ne në lartësi prej 31 m si dhe janë bërë edhe deblokime me automjetin cisterne me shtypje,, ne Marin ne Rr. Demir Ngucati ,debllokim, ne lagjen Balaj ne Llaushë, Ne fshatin Burojë, laxha Kastrati, ndërrim te gypit dhe deblokim te rrjetit te kanalizimit, në fshatin Kllodernicë , ndërrim gypi të shtypur, dhe deblokime,, në rr. Agim Ramadani ne Likoc, deblokim të kanalizimit, ne Rr. 17 shkurti mbrapa Mishtores “TREPÇA”.

Gjatë muajt Tetor, kemi angazhuar kompanitë kontraktues ne eliminimin e deponive ilegale nëpër fshatra, Nga Zyrtari Ligjorë janë lëshuar pëlqime, për ndërhyrje ne Infrastrukturë, si për kyçje ne rrjetin e kanalizimit, të ujësjellësit, dhe për bllokim të rrugëve, sipas kërkesave të kompanive ndërtimore për betonim të pllakave, ne ndërtesat banesore.

Në organizimin e punëtorive te ndryshme ne nivel vendi, punëtori te cilat kanë të bëjnë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, kemi dërguar Zyrtaret e sektorit, që të jenë pjesëmarrës në to, sipas natyrës së punës, e posaçërisht rreth menaxhimit të mbeturinave .

Kemi angazhuar Kompaninë “Deshishku” ne deblokimin e rrjetit te kanalizimit ne Rr. Gjon Buzuku, si dhe ne Rr. Emin Lati, kemi bërë edhe ndërrimin e kapakëve te rrjetit atmosferik, deblokim te rrjetit te kanalizimit ne Rrugën Magjistrale, afër pikës se karburanteve AL-Trade ne Polac, si dhe ne laxhen Lushtaku ne Prekaz, vendosja e disa kapakëve te dëmtuara te pusetave te kanalizimit, si ne Rr.17 Shkurt, Rr. 28 Nëntor, në Rr.18 Qershori.

Në muajin Nëntor dhe Dhjetor, kemi bërë shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave te Qytetareve, si dhe përgatitjen e planeve operative për vitin 2026 dhe Raportit vjetor të vitit 2025,

Raporti i lëndëve të proceduara në afatin ligjor

1.	Të Pranuara	311	Lëndë
2.	Të Aprovuara	246	Lëndë
3.	Të Refuzuara	52	Lëndë
4.	Të Ceduara	12	Lëndë
5.	Ne proces	0	Lëndë
6.	Pezulluara	0	Lëndë
7.	Hedhura poshtë	1	Lëndë
8.	Anuluara	2	Lëndë

Kompania e Ujësjesit - Njësia në Skenderaj									
Raporti i rrjedhjeve dhe debllokimi I kanalizimeve Dt:01.01.2025-31.12.2025									
Kërkesat		Kërkesat e realizuara ujësjellës	Kërkesat e realizuara te Kanalizimeve		Kërkesat e ardhura nga komuna për sanim te rrjedhjeve			Kërkesat e ardhura nga komuna për de bllokim te Kanalizimeve	
Nr.	Muajt	E sanuar	I Debllokuar		E sanuar			I Debllokuar	
		Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo
1	Janar	12		2					
2	Shkurt	16		2		1		1	
3	Mars	21		2		1			1
4	Prill	15		3					
5	Maj	15		3				1	
6	Qershor	15		3		1		1	
7	Korrik	13		3					1
8	Gusht	16		2				1	
9	Shtator	24		3				1	
10	Tetor	20		3					
11	Nëntor	17		3		1			
12	Dhjetor	20		4					1
Totali		204	0	33	0	4	0	5	3

Zyrtari Ligjor

-Ne bazë të detyrave dhe punëve zyrtar gjatë këtij viti kem kryere një mori punëve ne kuadër te drejtorisë për shërbime publike.

Pune administrative ne kuadër të fushës ligjore si: Përgatitja e lëndëve dhe procedimi për shqyrtim, pranimi i kërkesave dhe shkresave zyrtare, dhënien e pëlqimit për ushtrimin e veprimtarive të ndryshëm për bizneset dhe institucionet relevante.

Plotësim ndryshimet për aktet dhe rregulloret komunale, informonin e zyrtarëve për ndryshmet ligjore dhe akteve nen ligjore.

Gjete këtij viti kalendarike për veç detyrave të lartcekura kam kryer pune dhe detyra shtesë sipas kërkesave të shefit ne kuadër të sektorit, drejtorit dhe zyrës se kryetarit.

Ne bazë të vendimeve të kryetarit kam kryer pune dhe detyra si me poshtë.

-Punët e anëtarit të komisionit sipas vendimi të zyrës se kryetarit.

-Pune e menaxhimit të kontratave me operatorët të ndryshëm,

-Pjesëmarrja ne gupet punese ne kuadër të fushave specifike,

-Monitorimin e vendimeve dhe pëlqimeve të drejtorisë për afatet ligjore.

-Punët shtese të drejtorisë vlerësimin e lëndëve për zyrën e prokurimit dhe përgatitjen e raportit.

Ne tabelën me poshtë po paraqes vendimet e zyrës se kryetarit.

Nr.	Përshkrimi	Nr. i vendimit	Data
1	Vendimet për vlerësimin, menaxhimin e lëndëve dhe anëtar i komisioneve		
2	Mbikëqyrës i menaxherit të kontratës; Sigurimi fizik i objekteve te komunës se Skenderaj -Emergjente	02-020/01-0052441/23	09.10.2023
3	Mbikëqyrës i menaxherit të kontratës; Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve ne territorin e Komunës se Skenderaj gjatë sezonit dimëror”.	02-020/01-0055469/23	30.10.2023
4	Kryesues i komisionit për pranim të furnizimit për nevojat e DSHP-së.		20.10.2024
5	Kryesues ne grupin punës: Hartimin e draftit fillestar të Rregullores Komunale për kushtet dhe mënyrën e bllokimit dhe zhvendosjes se Automjeteve me Automarimangë	02-020/01-0023210/24	17.05.2024
6	Mbikëqyrës i kontratës: Ndryçimi publik ne qytet dhe fshatra	02-020/01-0027840/23	14.08.2024
7	Menaxher i kontratës: Mirëmbajtja e ndriçimit publike në komunën e Skenderajt.	02-020/01-0061169/23	06.12.2023

Ne këtë raport janë paraqit ne pika të shkurtër punët dhe detyrat e kryera gjatë këtij viti kalendarik, përveç punëve të lartcekura kemi krye edhe punën të pa planifikuara tjera sipas nevojave të drejtorisë për shërbime publike.

Drejtoria e Shërbimeve Publike përmes NPL Eko Natyrës ka marrëveshje për mirëmbajtjen :

1. Mirëmbajtjen dhe pastrimin e 8 hapësirave publike me 8966 m2 :
2. Mirëmbajtjen e tortuarve dhe rrugëve ne qytet dhe bashkësi lokale gjate sezonit vere:
3. Mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe ndriçimit publik, të gjitha hapësirat publike janë të pajisura me ndriçimi publik:
4. Gjithashtu përmes NPL Eko Natyra mirëmbahen rrugët gjatë sezonit veror duke u pastruar dhe mirëmbajtur.

Raporti i Pagesave te Faturave sa janë te paguara dhe sa janë të pa paguara Kompanisë “DESHISHKU GB”2025

Operatori Ekonomik: DESHISHKU GB-SHPK				
Titulli i kontrates : Mirembajtja e rrjetit te kanalizimit mbrenda teritorit te Komunes se Skenderajt				
RAPORTI I PUNIMEVE SI MBAS FATUEAVE ME SITUACIONE				
	Data e faturimit	Numri i fatures	VLERE E FATURAVE	PAGESAT
SITUACIONET ME FATURA PER VITIN 2024				
Situacioni i -I-		1.2024	7860.92	E paguar
Situaciono i -II-		2.2024	4959.4	E paguar
Situacioni i -III-		3.2024	19992.58	E paguar
Situacioni i -IV-		4.2024	15198.77	E paguar
Situacioni i -V-		6.2024	20218.34	E paguar
Totali i faturave per vitin 2024				68230.01
SITUACIONET ME FATURA PER VITIN 2025				
Situacioni i -VI-			20708.87	E paguar
Situacioni i -VII-			19848.36	e paguar
Situacioni i -VIII-			9589.23	JO e paguar
Situacioni i -IX-			21591.81	JO e paguar
Situacioni i -X-			39303.49	JO e paguar
Situacioni i XI-			728.23	JO e paguar
Totali i faturave per vitin 2025				111769.99
TOTALI I PUNIMEVE TE PUNUARA			180000.00	
BUXHETI I PA SHPENZUAR			0.00	
TOTALI FATURAVE TE PA PAGUARA PER V. 2025				71212.76

Zyrtarja Analistja e Buxhetit

Raporti i lëndëve të përgatitura për pagesë gjatë periudhës 01.01.2025 - 31.12.2025					
Nr. Ren	Muaji	Mallëra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione	Investime Kapitale
1	Janar	0	0	0	0
2	Shkurt	27	7	2	3
3	Mars	21	3	2	1
4	Prill	13	3	1	2
5	Maj	28	0	3	0
6	Qershor	19	1	2	1
7	Korrik	24	10	2	1
8	Gusht	21	2	5	0
9	Shtator	16	6	3	1
10	Tetor	3	6	1	0
11	Nentor	8	6	3	1
12	Dhjetor	0	5	3	1
Totali		180	49	27	11

Zyrtari për Menaxhim të Mbeturinave

-Gjate këtij viti të punës me poshtë do të paraqesim të gjitha aktivitetet e zhvilluara ne mbrojtjen e ambientit si dhe ngritjen e vetëdijes rreth menaxhimit të mbeturinave në Komunën e Skenderaj. Ne bazë të punëve dhe aktiviteve të zhvilluara për mirëmbajtjen e hapësirave publike ne komunën e Skenderaj kemi ndërmarr një serë aktivitetesh, si:

-Mirëmbajtjen e hapësirave publike, trajtimin e mbeturinave, angazhimi dhe mbikqyerja ka qenë intensiv dhe kemi pasur aktivitete të rregullta, aktivitete ditore ne mirëmbajtjen e hapësirave publike nga mbeturinat.

- Monitorimi i kompanisë Uniteti njësia ne Skenderaj ne baza ditore, kompania Uniteti në bazë të planit operativ ne bashkëpunim më komunën përkatësisht aktivitet bashkërendohen përmes zyrtarit për menaxhimin e mbeturinave, ku janë zhvilluar një serë aktivitetesh ne mbrojtje të ambientit.

Objektiva dhe aktivite të arritura gjate punës për vitin 2025

- *Menaxhimi i mbeturinave ne komunën e Skenderaj, Hartimi i planeve dhe strategjive komunale për menaxhimin e mbeturinave;*

- ✓ Monitorimi hapësirave publike për menaxhimin e mbeturinave,
- ✓ Planifikimi dhe trajtimi i mbeturinave,
- ✓ Organizimi dhe administrimi i mbeturinave
- ✓ Pjesëmarrja ne procesin e hartimit të draft plani ndër komunal për menaxhimin e integruat të mbeturinave ne bashkëpunim më komunat e regjionit si me komunat Mitrovicës, Vushtrisë dhe Skenderajt.
- ✓ Takime zyrtare me Giz-in dhe asociacionin e komunave-AKK ne Prishtinë për fushën e menaxhimi të mbeturinave.
- ✓ Pune dhe aktivitet tjera sipas kërkesave të shefit të sektorit dhe Drejtorit.
- ✓ Vlersimi i lëndëve sipas vendimeve të zyrës se kryetarit

- Hartimi i raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave;

- ✓ Monitorimi i rregullores komunale për MM
- ✓ Planifikimin e hapësirave për vendosjen e kontejnerëve
- ✓ Përcaktimi i pikave statike për mbeturina dhe rregullimi i tyre
- ✓ Vendosjen e shenjave për kujdesin ndaj ambientit për mos hedhje të mbeturinave,
- ✓ Identifikimi i deponive ilegale ne territorin e komunës se Skenderaj për vitin 2025,

Ne gjate identifikimi te deponive ilegale kemi ndërmarr hapa konkret për trajtimin e deponive dhe menaxhimin e mbeturinave ne territorin e komunës se Skenderajt. Trajtimi i deponive është bere me operator ekonomik ne bashkëpunim me kompaninë regjionale të menaxhimi të mbeturinave, KRM Uniteti Sh.A njësia ne Skenderaj. Me poshtë po para qesimin fshatrat ne komune e Skenderajt .

Nr. i deponive të trajtuara në fshatra e Komunës së Skenderaj gjatë vitit 2025

Nr.	Lokacioni i Deponive	E Vogël	E Mesme	E Madhe	Makro-Deponi	Totali
1	Skenderaj	7	3	2	1	13
2	Klinë e Epërme	1	2	1	1	5
3	Klinë e Mesme	2	1	1		4
4	Klinë e Poshtme	1	2	1		4
5	Ternave		1			2
6	Kuqicë		2	1		3
7	Prekaz i Epërme		2	1		3
8	Prekaz i Poshtme		3	1		4
9	Polac		2	2	1	5
10	Kryshec		2	1	1	4
11	Llaushë		2	1	1	4
12	Morinë	1	1			2
13	Makerrmal	1	2	2		5
14	Rezallë		1	1	1	3
15	Likoc	2	1	1		4
16	Ticë			1	1	2
17	Plluzhinë		1	1		2
18	Abri e Poshtme		1	2	1	4
19	Dashec		1		1	2
20	Baks		1			1
21	Qirez		2	1	1	4
22	Kozhicë	2	1			3
23	Krasaliq		1	1		2
24	Prelloc	1	1			3
25	Krasmirovc		1			1
26	Çubrel		1			1
27	Vitak		1	1		2
28	Runik		2	1		3
29	Kosterre					
30	Pemishte					
31	Syriganë					
32	Radishevë			1		1
33	Bajë					

34	Leqinë		1	1		2
35	Çitak		1			1
36	Izbicë		1	2		3
37	Vajnikë	1	1	1	1	4
38	Burojë			1		1
39	Kopiliq i Epërme			2	1	3
40	Kopiliq i Poshtëm		1	1	1	3
41	Turiqec			1	1	2
42	Aqarëve	1		1		2
43	Rakinicë		1	1		2
44	Klladerrnicë			1		1
45	Tushilë			1		1
46	Kotorr		1	2		3
47	Lubavec			1	1	2
48	Mikushnicë		1	1		2
49	Murgë					
TOTALI:		20	49	42	15	126

Ne kuadër të aksionit të eliminimit të deponive ilegale në për disa fshatra të komunës së Skenderaj,

Përshkrimi	Sasia e deponive
Deponi të vogla	20
Deponi të mesme	49
Deponi të mëdha	42
Mako-deponi të mëdha e të përziera	17
Totali:	126 Deponi

Krahas gjitha aktiviteteve të zhvilluara në mbrojtje të ambientit, kemi ndërmarr hapa konkret në mbrojtjen e qëndrueshme të ambientit.

Punë administrative në zyrë.

-Në kuadër të vlerësimit të lendeve sipas vendimeve të kryetarit kam bërë vlerësimin e mbi 10 lendeve për operator të ndryshëm.

-Pjesëmarrja në takime zyrtare mbi 15 takime me organizata dhe institucione vendore dhe ndërkombëtare.

-Menaxhimi i kontratave sipas vendimeve të zyrës së kryetarit gjithsej 3 kontrata,

Në vijim, për të lehtësuar procesin e alokimit të buxhetit dhe për të siguruar transparencë të plotë, punët e kryera dhe faturimi total janë ndarë sipas dy drejtorive përkatëse, bazuar në natyrën e shërbimeve të ofruara.

Detajet janë si më poshtë:

Tabela 5: Përmban listën e detajuar të të gjitha punëve dhe kostove që i atribuohen **Drejtorisë për Shërbime Publike**, në përputhje me shërbimet e specifikuar në marrëveshje.

Nr.	Hapsirat Publike/Emertimet	Punet e kryera	Njesia	Sasia	Çmimi	Çmimi Total
1	Mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale të specifikuar në tabelen 1 të Shtojces 1	Kositja, grabujimi dhe bartja e barit në/nga të gjitha hapësirat publike të gjelbëruara që llogariten si mbeturina që rrjedhin nga kopshti, nga parku dhe mbeturina që kompostohen.	m ²	14370	0.30€	4,311.00 €
2	Mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale të specifikuar në tabelen 2 të Shtojces 1	Pastrimi i rregullt, mbledhja dhe largimi i të gjitha mbeturinave të vogla komunale (si letra, ambalazhe plastike, shishe, etj.) dhe mbetjeve të tjera nga sipërfaqet e hapësirave publike	m ²	35140	0.30€	10542 €
3		Totali I Përgjithshem				14,853.00 €

Tabela 6: Përmban listën e detajuar të të gjitha punëve dhe kostove që i atribuohen **Drejtorisë për Shërbime Publike**, në përputhje me shërbimet e specifikuar në marrëveshje për Objektet Komunale.

Nr.	Hapsirat Publike/Emertimet	Punet e kryera	Njesia	Sasia	Çmimi	Çmimi Total	
1	Qendra e Kultures "Hasan Prishtina"		m ²	2000	2.00	4000 €	
2	Objekti i Administrates së Komunes		m ²	3000	2.00	6000 €	
Sherbimi sipas Nenit 4, nenpika 1.2.7.2 nga tabela 9.						Totali	10,000.00 €
3	Mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale të specifikuar në tabelen 9 të Shtojces 1	Pastrimi dhe mirëmbajtja e higjienës për të gjitha objektet e institucioneve publike të menaxhuara nga ana e komunës. Pastrimi përfshinë: pastrimin e dyshemeve (larje dhe dezinfektim), pastrimin e të gjitha sipërfaqeve të inventarit (tavolina, karrige, rafte)					
						Totali i Përgjithshem	10,000.00 €

Tabela 6: Përmban listën e detajuar të punëve dhe kostove që i takojnë **Drejtorisë së Shëndetësisë**, duke përfshirë shërbimet specifike të kërkuara nga kjo drejtori.

Nr	Hapsirat Publike/Emertimet	Punet e kryera	Njesia	Sasia	Çmimi	Çmimi Total		
1	QKMF-Skenderaj		m ²	4000	2.50€	10000€		
2	Shtëpia e personave të Moshuar (SHPMPPF)		m ²	800	2.50€	2000 €		
Sherbimi sipas Nenit 4, nenpika 1.2.7.1 nga tabela 8.						Totali	12,000.00 €	
3	QMF-Likoc		m ²	250	2.00€	500 €		
4	Qendra për Punë Sociale		m ²	450	2.00€	900 €		
5	Qendra e personave me aftësi të kufizuara		m ²	250	2.00€	500 €		
Sherbimi sipas Nenit 4, nenpika 1.2.7.2 nga tabela 9						Totali	1,900.00 €	
6	<i>Mirëmbajtjen e hapësirave publike komunale të specifikuar në tabelën 8 dhe 9 të Shtojcës 1</i>	<i>Pastrimi dhe mirëmbajtja e higjienës për të gjitha objektet e institucioneve publike të menaxhuara nga ana e komunës. Pastrimi përfshinë: pastrimin e dyshemeve (larje dhe dezinfektim), pastrimin e të gjitha sipërfaqeve të inventarit (tavolina, karrige, raftë)</i>						
						Totali i Përgjithshëm	13,900.00 €	

-Përgatitja e specifikave të ndryshëm për planet e drejtorisë.

Ne këtë raport po e paraqes pune tim ne pika me të shkurta pasi qe kemi krye edhe pune të pa planifikuara sa i përket aktiviteteve tona ne Drejtorin e Shërbimeve Publike.

Ne këtë raport janë prezantuar pune dhe aktivitete ne pika të shkurta të realizuar nga puna ime zyrtare ne sektor të ndryshëm për posë punëve dhe detyrave tjera ne përgjithësi.\

Disa nga objektivat e arritura në vitin 2025

- Pjesëmarrja aktive në realizimin e disa projekteve kyçe, duke kontribuar në përmbushjen e afateve dhe standardeve të cilësisë.
- Përmirësimi i proceseve teknike dhe komunikimit brenda ekipit, që ka çuar në rritjen e efikasitetit dhe zvogëlimin e gabimeve.
- Angazhimi në zhvillimin e strategjive për të optimizuar përdorimin e resurseve dhe teknologjive të reja.
- Pjesëmarrje në trajnime të fushave të ndryshme si dhe certifikime si në: Menaxhimin e Mbeturinave, Ndihmën e parë së bashku me ekipin e KFOR-it, Trajnimi bazik i forumeve të sigurisë për reagim emergjent në Akademinë për Siguri Publike, Trajnim në Akademinë për Siguri Publike së bashku me OSCE.

Viti 2025 ka qenë një periudhë e suksesshme për mua si Koordinator për Punë Teknike, ku kam kontribuar në menaxhimin dhe realizimin e projekteve në mënyrë të suksesshme. Me angazhimin dhe përkushtimin tim, arritëm të përmbushim detyrat dhe objektivat e planifikuara. Jam i gatshëm të vazhdoj të përmirësoj proceset dhe të siguroj që projektet e ardhshme të realizohen në mënyrë efektive dhe efikase.

Zyrtari Koordinator për punë Teknike

Si Koordinator për Punë Teknike, Gjatë këtij viti kalendarik ka qenë i angazhuar në një sërë aktivitete të cilat janë zhvilluar në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike.

1. Raportimi dhe Dokumentimi:

- Përgatitja e raporteve të rregullta mbi progresin e punës, duke përfshirë rezultatet e arritura dhe çdo sfidë të hasur.
- Sigurimi që të gjitha dokumentet dhe planifikimet të ishin të përditësuara dhe të mbaheshin në përputhje me procedurat e brendshme.

Në bazë të vendimeve të kryetarit kam kryer punë dhe detyra si më poshtë:

- Punë të anëtarit të komisionit sipas vendimit të zyrës së kryetarit.,
- Punë të menaxhimit të kontratave me operatorët ekonomik.,

Punët administrative që ka kryer gjatë këtij viti kanë qenë: Pranim i lëndëve të ndryshme (Kërkesa, Vendime, Ankesa, Raporte etj), Regjistrim në librën e Protokolit, Mbylljen e lëndëve në librën e Protokolit, Raportet e punëve të kryera.

Punë Administrative ne zyre.

-Ne kuadër të vlerësimit të lendeve sipas vendimeve të kryetarit kam bërë vlerësimin e 3 kontratave për operator të ndryshëm.

-Pjesëmarrja ne takime zyrtare mbi 7 takime .

-Përgatitja e specifikave të ndryshëm për planet e sektorit për shërbime Publike për vitin 2025.

Ne këtë raport po e paraqes pune tim ne pika me të shkurta pasi qe kemi krye edhe pune të pa planifikuara Ne këtë raport janë paraqit ne pika të shkurtër pune dhe detyrat e kryera gjate këtij viti kalendarik, për veç punëve të lartcekura kemi krye edhe punën të pa planifikuara dhe të fushave tjera sipas nevojave te drejtorisë për shërbime publike jan planifikuara dhe të fushave tjera sipas nevojave te drejtorisë për shërbime publike.

Anëtarit të komisionit i emëruar me vendim të kryetarit për menaxhimin dhe vlerësimin e punëve të operatorëve kontraktues nga Komuna.

Me kërkesën tuaj, ju dërgojmë Raportin Vjetor për punët dhe detyrat e punës për Sektorin për Shërbime Publike, në pika të shkurta..

RAPORTI I PUNES PËR VITIN 2025

Sektori Mbrojtje dhe Shpëtim

- Është dorëzuar Raporti i punës për vitin 2025 me të gjitha të dhënat e punës dhe aktivitete tjera në formën tabelare të cilat janë në përputhje me kërkesën për performancën Komunale .
- Plani i punës për vitin 2025 është punuar dhe dërguar për miratim.
- Janë kryer me kohë vlerësimet për punën e të gjithë zyrtarëve të Sektorit për MSH në bazë të formularit nga zyra e personelit .
- Me dt.10-11. Janar kemi pasur reshje të bores dhe kompania për pastrimin e bores ka dalur dhe ka pastruar të gjitha rrugët lokale të cilat janë bërë të kalueshme për qytetaret tanë , kjo punë është mbikëqyre nga zyrtaret tanë.
- Raporti për punët e kryera nga Plani Operativ Emergjent Lokal është dorëzuar si dokument për plotësim të kriterëve të performancës komunale .
- Është mbajtur takimi i punës i komisionit për riatdhësim dhe ri integrim të personave të kthyer nga BE dhe për dy raste kemi marrë vendimi për vazhdim të akomodimit .
- Raporti për pagesë OE "Ejona" për mirëmbajtje të ashensorëve edhe punë tjera SHP nga Drejtori .
- Pagesa për OE "Ipko" dhe aktivizimi i sim-kartelevë zyrtare në QKMF.
- Në bashkëpunim me policinë e lagjes z.Ahmet Lushtaku kemi vizituar shtëpinë e stër vjetruar në fsh. Klinë e Eperme në rr. "Ramadan Bajraktari" e cila paraqet rrezik nga shembja .Kjo shtëpi ka qenë shtëpi e frontit, konvikt etj. në kohëra të hershme por tash është e pabanuar dhe familja që është afër dhe për të tjerët paraqet rrezik. Kemi rekomanduar rrënimin e saj.
- Kemi shqyrtuar edhe një kërkesë të Veli Bytyqit me banim në Fushë Kosovë që ka paraqitur për pastrimin e gërmadhave në trillin e tij në fsh. Abri e Poshtme ku kemi konstatuar një rrezik të shkallës së ulët .
- Zyrtari për Emergjencë ka qenë pjesë e komisionit për rekrutim për pozitën „Zyrtar administrativ“.
- Me dt.07.03.2025. kemi qenë të angazhuar në Naten e zjarreve të „Epopesë së Jasharajve “ në Prekaz .
- Nga AME dhe QOER kemi pranuar kërkesën për Planin e trajnimeve për vitin 2025 që do të mbahen gjatë tërë vitit në Akademinë Policore dhe të Sigurisë në Vushtrri dhe me kohë kemi dorëzuar Planin me të dhënat e zyrtarëve tanë që do të marrin pjesë.
- Me dt.03-07.03.2025. është mbajtur trajnimi në APSE me titull "Bazat e menagjimit emergjent"
- Me 02-04.04.2025., „Vlersimi i Rreziqeve“, me dt.10-11.04.2025. trajnimi „Zvogëlimi i Rreziqeve“.
- Me dt.23.03.2025. është zhvilluar një aktivitet i përbashkët me Drejtorinë e Bujqësisë për gruposjen e dy kafshëve të sëmura të verifikuara nga AVUK dhe punët e përbashkëta janë kryer me kohë.

- Komisioni për vlerësimin e dëmeve ka dalur ne teren dhe ka vlerësuar ne tremujorin e parë 25 kërkesa për dëme nga era, zjarri etj. e vlera e dëmeve është 42.000 €.
- Ne këtë tremujor kemi pasur 76 raste te vdekjeve.
- Zyrtari për emergjenca ka qenë anëtar i komisionit për vlerësim të tenderit “Furnizim dhe Mbjellje e Luleve – Drunjtëve në Hapësirat Gjelbëruese të Qytetit – Ri tender”.
- Raport për pagës në mirëmbajtje dhe servisim të ashensorëve për operatorin ekonomik “EJONA”
- Raport për pagesë të operatorit mobil “IPKO”, për muajin Prill 2025.
- Komision për vlerësim të dëmeve në fshatrat: Llaushë, Rakinicë, Prekaz i Poshtëm, Dashec.
- Në Prishtinë është mbajtur Trajnimi i avancuar për komunikimin strategjik dhe marrëdhëniet me publikun i nivelit qendror nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave edhe OSBE me zyrtaret emergjent, zjarrfikëset etj.
- Me dt.24.05.2025.një zjarr i madh ka përfshire shtëpinë e banimit,ahrije,shtallë ushqimi te kafshëve, automjete, makineri bujqësore, garazhe ,shtëpi ndihëmese,4 lopë te ngordhura te familjes Bytyqi ne fsh. Abri e Poshtme .Demet janë te mëdha. Në vendngjarje kanë dalur Zjarrfikëset, Policia e Kosovës, Inspektori i parandalimit dhe Zyrtarë emergjent .
- Intervenim se bashku me ekipin e zjarrfikësve në fshatin Kline e Mesme për prerjen e plepit i cili ka rrezikuar jetën e qytetarëve.
- Raport për pagese mujore te operatorit ekonomik mobil “IPKO” për muajin maj.
- Ne teren kemi vizituar familjen e Elmi Buzhelës ne fsh.Likoc i Ri sipas kërkesës se tij për rrënimin e një shtëpie te vjetër dhe te përfshirë nga zjarri dhe kemi vlerësuar te nevojshme , por ne mungesë te një kompanie shërbyese nuk kemi pasur mundësi ta kryejmë.
- Komision për vlerësim të dëmeve të shkaktuara nga zjarri, fshati Abri, Plluzhinë.
- Janë kryer punët nga Komision për pranim teknik “Riparimi dhe Zgjerimi i Vend-ndaljeve për Autobusë dhe Mbulimi i tyre”.
- Është bërë kërkesë për aktivizim të sim-karteleva zyrtare ndaj operatorit ekonomik mobil “IPKO”.
- Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve e ka përmbledhë punën ne vlerësimin e dëmeve nga era, zjarret etj. ne gjashtëmujorin e parë te këtij viti ne 42 raste prej tyre ,36 bujqësi dhe 6 ekonomi familjare ku shuma e përgjithshme ne total është 217.481.49 €.
- Ne gjashtëmujorin e pare te këtij viti ne komunën tone kemi pasur 152 vdekje.
- Me dt.30.06.2025. kemi pritur ne takim zyrtaret e lartë nga Ministria e PHI te caktuar për Pellgun e lumit te Drinit ku derdhen edhe lumenjtë e komunës tone .I kemi vizituar disa segmente te lumit Klina ,Jasharajve dhe lumit Qubrelit, Impiantin e ujërave te zeza ne Llaushë.

- Ne bashkëpunim i kemi propozuar segmentet me emergjente te lumenjve për pastrimin e tyre dhe rregullimin si masa parandaluese nga vërshimet. I kemi vendos te dhënat dhe pasqyruar me foto nga tereni .Te njëjtat i kemi përcjellore për miratim ne MPHI ne Prishtinë.
- Ne fshatin Lubavec me kërkesën e Zenel Rames kemi dale për vlerësimin e gjendjes nga rrëshqitja e gurëve ne oborrin e tij dhe për rreth. Kemi konstatuar rrezikun dhe kemi propozuar masat siç asht dhanja e Pëlqimit për largimin e masës gurore dhe rrafshimin e tyre si masë mbrojtëse për njerëzit e asaj familje .
- Muaji Korrik ka qenë muaji i temperaturave shumë te larta dhe si shkak kemi pasur numër te madh zjarresh ne pyje, ara dhe afër lagjeve te banueshme dhe afër Manastirit te Deviqit.
- Angazhimi i NJZSH ka qenë tepër azhur edhe permanent ne shuarjen e zjarreve, Policia e Kosovës ka bashkëpunuar me te gjithë dhe Komuna e ka ndihme me resurse teknike dhe humane nga KP „Eko natyra”. Edhe KFOR-i është angazhuar për shuarjen e zjarreve për rreth Kishës se Deviqit ne Llaushë me helikopterë duke gjuajtur topa uji. AME ishte ne teren.
- Një takim te përbashkët e kemi mbajtur me KFOR-in slloven ne zyret tona ku se bashku me Drejtorin i kemi njoftuar me detyrat e Drejtorisë dhe punët tjera ne interes për qytetaret tanë. Kanë qenë falënderues për bashkëpunimin tone e sidomos angazhimin rreth Deviqit.
- Është mbajtur takimi i komisionit komunal për Ri integrim dhe Ri atëdhesim ku është shqyrtuar vazhdimi i akomodimit për një familje e cila sipas Rregullores nuk pati mundësi por ju la mundësia e ankesës ne nivel qendror. Angazhimi ynë ne teren me rastin e zjarreve ne fshatin Polac dhe Prekaz ku ishin te rrezikuara shtëpitë e banimit te banorëve te asaj zone .
- Bashkëpunimi me PK rreth punëve qe na përshkohen siç janë intervenimet ne raste emergjente dhe natyrave tjera p.sh. shqetësimet e banorëve te fsh. Qirez nga shpërthimet ne një gurëthyes i afërt te cilat PK i ka përcjell Agresionit për Miniera e Minerale .
- Kërkesë e MPHI ishte te informojmë dhe ti dërgojmë Planin për Përmbytje me te dhëna për kohen dhe zbatimin e tij qe ne e kemi si komunë POEL ku janë te inkorporuara ,ju kemi dërguar me kohë.
- Angazhimi ynë në teren ne fsh.Polac e Prekaz me Shërbimin e Zjarrfikëseve për reagim ne shuarjen e zjarreve ku ishin te rrezikuara disa familje ne lagjet Veliu dhe Kodra ku shtëpitë e tyre te banimit janë shpëtuar .Takim pune me zyrtaret e Bankës Botërore(Zana Hoxha)dhe Kryqi i Kuq i Kosovës dhe KK-Skenderaj ku AME është përfituese nga Bashkimi Evropian ne implementimin e projektit, Ngritja e njohurive për zvogëlimin e rrezikut „Parashikimi i bazuar ne ndikim dhe paralajmërim te hershem në Kosovë”. --Te njëjtën punëtori e kemi vazhduar me te gjithë akterët emergjent ne nivel vendi dhe jemi dy komonat e Kosovës e Skenderajt edhe e Vushtrisë përfituese e këtij projekti.
- Me dt. 18.11.2025.kemi pasur reshje shiu te pandërprera 24 orë me intensitet te ulët edhe pse nivelet e ujit nuk kemi rritje por ekipet tona kanë dalur ne teren kanë konstatuar dalje te ujërave te zeza sidomos para objektit tregtar „Viva” ku gjendja e krijuar do trajtim për rregullim te gypave dhe pusetave atje .

- Nga këto reshje te shiut kemi pasur rrëshqitje te dheut dhe dëmtim te shtëpisë se Zymer Gashit ne l-6,Skenderaj ku komisioni do ta vlerëson .
- Kemi marr pjesë ne punëtorinë e organizuar nga Ambasada e Britanisë ne Kosovë dhe BIRN ne Zhvillimin e Kapaciteteve nder institucionale ne ndërtimin e strategjive për mbrojtje nga dezinformomi.
- Zyrtaret për Emergjencë kanë qenë pjesë e shumë komisioneve te punës ne nivel komune siç janë :komisioni për mirëmbajtje te rrugëve nga bora, komisioni për ndriçim publik, menagjim ne mbjelljen e luleve, de bllokim te kanalizimeve, korrje-shirjeve, mirëmbajtje e ashensorëve etj.
- Janë kryer punë ne zyre dhe teren sipas kërkesave te Drejtorisë dhe qytetarëve .

Tabela 1.

Intervenimet 2025				
NR	Emërimet	Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim - SMSH	Njësia Profesionale e Shërbimit të Zjarrfikësve - NJPSHZ	GJITHSEJ
1	Intervenimet në fatkeqësi natyrore	74		74
2	Vërshimet, Era, Zjarre, Ngrica	1,33,26,8		68
3	Shërbimet teknike	8		8
4	Shuarja e zjarreve		378	378
5	Intervenimet teknike		39	39

Tabela 2.

Vlerësimet e dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera-2025				
NR	Emërimet	Nr. i rasteve	Shuma	GJITHSEJ
1	Demet në Bujqësi	54	217,481.49 €	217,481.49€
2	Demet ne Ekonomi Familjare	12	421,030.71€	421,030.71€
3	Demet ne Biznese	0	0	0
4	Infrastruktura	0	0	0
5	Institucione tjera	0	0	0
	TOTALI :		638,512.2 €	

Tabela 3.

Vdekjet 2025/ Kontrata Komunë-BIK-u												
Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Numri	22	29	25	26	29	21	26	24	21	33	30	30
TOTALI: 316 raste												